KIRFN Interpretimi 19
Shlyerja e Detyrimeve Financiare me Instrumentet e Kapitalit Neto

Referencat

- *Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare* [1]
- SNRF 2 *Pagesa të bazuara në aksione*
- SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*
- SNRF 9 *Instrumentet financiare*
- SNRF 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*
- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja*

Konteksti

1 Një debitor dhe kreditor mund të ri negociojnë kushtet e një detyrimi financiar me pasojë që debitori të shlyeje plotësisht ose pjesërisht detyrimin duke emetuar instrumente të kapitalit neto tek kreditori. Këto transaksione referohen ndonjëherë si 'borxhe për shkëmbime në kapital neto'. KIRFN ka marrë kërkesa për udhëzime në kontabilitet për këto transaksione.

Objekti

2 Ky interpretim i adresohet kontabilitetit sipas njësisë ekonomike kur kushtet e një detyrimi financiar ri negociohen dhe sjellin në një njësi ekonomike emetimin e instrumenteve të kapitalit neto në një kreditor të njësisë ekonomike për të shlyer të gjithë ose pjesë të detyrimit financiar. Ai nuk i adresohet kontabilitetit sipas kreditorit.

3 Një njësi ekonomike nuk do ta zbatoje këtë Interpretim në transaksione në situata ku:

(a) kreditori është gjithashtu një aksionar direkt ose indirekt dhe po vepron në aftësinë e tij si një aksionar ekzistues direkt ose indirekt.

(b) kreditori dhe njësia ekonomike kontrollohen nga e njëjta ose të njëjtët palë përpara dhe pas transaksionit dhe thelbi i transaksionit përfshin një shpërndarje në kapital neto nga njësia ekonomike ose kontribut tek ajo.

(c) shlyerjen në detyrim financiar duke emetuar aksione në kapital neto në përputhje me kushtet origjinale të detyrimit financiar.

Çështjet

4 Ky Interpretim trajton çështjet në vijim:

(a) A janë emetuar instrumentet e kapitalit neto të njësisë ekonomike për të shlyer të gjithë ose pjesë të një "shume të paguar" të detyrimit financiar në përputhje me paragrafin 3.3.3 të SNRF 9?

(b) Si mund një njësi ekonomike të masë fillimisht instrumentet e kapitalit neto të emetuara për të shlyer këtë detyrim financiar?

(c) Si mund një njësi ekonomike të kontabilizojë diferencat midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të shlyer dhe vlerës fillestare të matjes së instrumenteve të kapitalit neto të emetuar?

[1] Referenca është për *Kuadrin e përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare,* të KSNK-së të miratuara nga Bordi në vitin 2001 dhe që u fut në fuqi në kohën kur u hartua Interpretimi.

Konsensusi

5 Emetimi i instrumenteve të kapitalit neto të një njësie ekonomike në një kreditor për të shlyer të gjitha ose pjesë të një detyrimi financiar është shumë e paguar në përputhje me paragrafin 3.3.3 të SNRF 9. Një njësi ekonomike duhet të fshijë një detyrim financiar (ose pjesë të një detyrimi financiar) nga pasqyra e saj e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, ajo të jetë shlyer në përputhje me paragrafin 3.3.1 të SNRF 9.

6 Kur instrumentet e kapitalit neto që i emetohen një kreditori për të shlyer të gjitha ose pjesë të një detyrimi financiar njihen fillimisht, një njësi ekonomike i mat ato në vlerën e drejtë të instrumenteve të kapitalit neto të emetuar, nëse kjo vlerë e drejtë mund të matet besueshëm.

7 Nëse vlera e drejtë e instrumenteve në kapital neto të emetuar nuk mund të matet me besueshmëri atëherë instrumentet e kapitalit neto do të maten për të pasqyruar vlerën e drejtë të detyrimit financiar të shlyer. Në matjen e vlerës së drejtë të një detyrimi financiar të shlyer i cili përfshin një tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat), paragrafi 47 i SNRF 13 nuk zbatohet.

8 Nëse shlyhet vetëm një pjesë e detyrimit financiar, njësia ekonomike do të vlerësojë nëse disa prej shumave të paguara lidhen me një modifikim të kushteve të detyrimit i cili mbetet aktiv. Nëse pjesë të shumave të paguara kanë lidhje me një modifikim të termave të pjesës së mbetur të detyrimit, njësia ekonomike do të shpërndajë shumat e paguara midis pjesëve të detyrimit të shlyer dhe pjesës së detyrimit që mbetet e pa shlyer. Njësia ekonomike do të konsiderojë të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse që lidhen me transaksionin në kryerjen e kësaj shpërndarje.

9 Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar (ose pjese të një detyrimi financiar) të shlyer dhe shuma e paguar, do të njihet në fitim ose humbje, në përputhje me paragrafin 3.3.3 të SNRF 9. Instrumentet e kapitalit neto të emetuar do të njihen fillimisht dhe të maten në datën e shlyerjes së detyrimi financiar (ose pjese të këtij detyrimi).

10 Kur vetëm një pjesë e detyrimit financiar shlyhet, shuma shpërndahet në përputhje me paragrafin 8. Shuma e shpërndarë në detyrimin e mbetur do të formojë pjesë të vlerësimit nëse kushtet e këtij detyrimi të mbetur janë modifikuar në mënyrë thelbësore. Nëse detyrimi i mbetur është modifikuar në mënyrë thelbësore, njësia ekonomike do ta kontabilizojë modifikimin si shlyerje të detyrimit fillestar dhe njohjen e një detyrimi të ri siç kërkohet nga paragrafi 3.3.2 të SNRF 9.

11 Një njësi ekonomike do të paraqesë një fitim ose humbje neto të njohur në përputhje me paragrafët 9 dhe 10 si një nënzë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose do të japë informacion shpjegues në shënimet.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

12 Një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për periudha vjetore duke nisur nga ose pas datës 1 korrik 2010. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë e cila fillon përpara datës 1 korrik 2010, ajo duhet ta paraqesë këtë fakt.

13 Një njësi ekonomike aplikon një ndryshim në politikat kontabël në përputhje me SNK 8 duke filluar nga periudha më e hershme krahasuese e paraqitur.

14 [Fshirë]

15 SNRF 13, e publikuar në maj 2011, ndryshoi paragrafin 7. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.

16 [Fshirë]

17 SNRF 9 i publikuar në korrik 2014 ndryshoi paragrafët 4, 5, 7, 9 dhe 10 dhe fshiu paragrafët 14 dhe 16. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.

18 SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafin 11. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

 © Fondacioni i SNRF-ve